



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1784/14 Prot.

Pogradec, më 05.05 .2026

VENDIM

NR. 53, DATË 30.04.2026

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 30.03.2026 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 30.03.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 30.03.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLI

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 24 vota

2. Vota Pro 24

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 30.04.2026

ORA : 12:00

JANË PREZENT 22 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
DATE 30.02.2026 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :**Miratimi i Procesverbalit të datës 25.02.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 25.02.2026.
5. **Projekt – Vendim:**Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Shkurt 2026.
6. **Projekt – Vendim :** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 13.5 Ha, e ndodhur në Njësinë Administrative Bucimas që mund të jepen me qira.
7. **Projekt – Vendim :** Për përjashtimin e përkohshëm nga tarifat vendore për subjektet që ushtrojnë aktivitet në zonën historike A, për ti dhënë mundësi zhvillimi kësaj zone.
8. **Projekt – Vendim :** “Miratimin e Tavanëve Përgatitore të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec ”
9. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Pogradec .
- 10.**Projekt – Vendim:** Për procedurën e realizimit të shpronësimit të pasurive që preken nga realizimi I projektit të sistemimit të rrugës të blloku, “ Përroi I Caprazit” , për interes publik” .
- 11.**Projekt – Vendim :** Për dhënien e ndihmës financiare për z.Hysni Mahmutllari, familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake si pasojë e përmytjes.
- 12.**Projekt – Vendim :**Për dhënien e ndihmës financiare për z.Klajdi Afesllari, familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje si pasojë e përmytjes.

13. **Projekt – Vendim** : “ Për dhënien e ndihmës financiare për z. Haskeri Dervishllari, familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje si pasojë e përmbytjes”.
14. **Projekt – Vendim** : “Për dhënien e ndihmës financiare për znj. Leontina Tasellari , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”
15. **Projekt – Vendim** : “Për dhënien e ndihmës financiare për z.Pirro Prifti , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”
16. **Projekt – Vendim** : “Për dhënien e ndihmës financiare për z.Fari Laraku , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”
17. **Projekt – Vendim** : “Për dhënien e ndihmës financiare për znj.Violeta Piqoni , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”
18. **Projekt – Vendim** : “Për dhënien e ndihmës financiare për z.Sokol Elmasllari, familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”
19. **Projekt – Vendim** : “Për dhënien e ndihmës financiare për z.Ferit Afëzi, familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”
20. **Projekt – Vendim** : Për dhënien e ndihmës financiare për z.Nihat Afesllari, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.
21. **Projekt – Vendim** : Për dhënien e ndihmës financiare për z.Eqerem Yzellari, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.
22. **Projekt – Vendim** : Për dhënien e ndihmës financiare për z.Bujar Fezollari , familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.
23. **Projekt – Vendim** : Për dhënien e ndihmës financiare për z.Luan Kuqo, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.
24. **Projekt – Vendim**: Për dhënien e ndihmës financiare për z.Lazaron Naco , familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.
25. **Projekt-Vendim**: “Miratimin e cmimit maksimal ditor për shfrytëzimin e setit cadër plazhi+ 2 shezlog, në plazhin e Bashkisë Pogradec nga subjektet private që ushtrojnë veprimtari si stacione plazhi”.
26. **Projekt-Vendim**: Për krijimin e tregjeve publike për tregëtimin e produkteve të ndryshme, në njësitë administrative Trebinjë dhe Proptisht.



Znj. Kryetare: Përshëndetje të gjithëve. Jemi mbledhur sot në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, në zbatim të rregullores së Këshillit Bashkiak dhe të ligjit nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore'. Vazhdojmë me verifikimin e pjesëmarrjes. Ju lutem.

Sekretarja e Këshillit: Janë të pranishëm 21 këshilltarë. Mbledhja deklarohet e hapur.

M.Kamolli: Nga administrata kemi dy Projekt-Vendime shtesë. Projekt-Vendimi I parë është sjellë nga administrata pasi është zhvillua konsultimi public në datën 26.03.2026, dhe projekt-vendimi tjetër është krijimin e tregjeve në Trebinjë dhe në Proptisht. I hedhim të dy projekt-Vendimet në votim për tu futur tek rendi I ditës.

- **Projekt-Vendim:** "Miratimin e cmimit maksimal ditor për shfrytëzimin e setit cadër plazhi+ 2 shezlog, në plazhin e Bashkisë Pogradec nga subjektet private që ushtrojnë veprimtari si stacione plazhi".

M.Kamolli: Ehedhim në votim.

J.Bojko; Miratohet me 21 vota Pro për tu future tek rendi I ditës.

Projekt-Vendim: Për krijimin e tregjeve publike për tregëtimin e produkteve të ndryshme, në njësitë administrative Trebinjë dhe Proptisht.

M.Kamolli: E hedhim në votim.

J.Bojko: Miratohet me 21 vota pro për tu futur tek rendi I ditës.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.

M.Kamolli: Hedhim në votim atëherë Rendin e ditës.

J.Bojko: Miratohet me 21 vota Pro pika e parë e Rendit të ditës.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

2. Projekt – Vendim :Miratimi i Procesverbalit të datës 25.02.2026.

M.Kamolli: Nqs nuk ka dikush ndonjë koment e hedhim në votim .

J.Bojko: Miratohet me 21 vota Pro pika e dytë e rendit të ditës.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

M.Kamolli: Nqs ndonjë nga Këshilltarët ka konflikt interesi duhet ta deklarojë që në fillim.

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Julij' or similar, written in a cursive style.

4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 25.02.2026.

M.Kamolli: Po lexoj Konfirmimin e prefekturës në lidhje me vendimet e mbledhjes së datës 25.02.2026.

K.Topa: Doja të shtoja dicka tek Vendimi I Nivelit të pagave që kemi miratuar, pra duhet të sqaroja , përputhshmëri ligjore është zbatuar pra do të thotë që në bazë të VKM është zbatuar minimum dhe maximum I, pra jemi Brenda kufijve ligjorë. Është bërë një lapsus lidhur me klasën pa ndikur te paga, I cili duhet rregulluar. Prefektura sygjeron ekzekutivin që ta korigjojë, nuk është e thënë pikërisht sot, mund të bëhet dhe në një projekt-vendim të ardhshëm të pagave ose të vijë me një projekt-vendim të ri.



5. Projekt – Vendim:Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Shkurt 2026.

M.Kamolli : Vazhdojmë me projekt-vendimin e rradhës. Kemi dicka nga komisioni? Është e nevojshme ndonjë sqarim nga administrate?

Atëherë e hedhim në votim

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



6. Projekt – Vendim : Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 13.5 Ha, e ndodhur në Njësinë Administrative Bucimas që mund të jepen me qira.

Znj. Kryetare: Ka ndokënd nga komisionet që ka dëshirë të shprehet? Kush mori pjesë në komisione? Konsultimi publik është bërë?

Znj. Topa: Përshëndetje. Po, është bërë konsultimi publik që në muajin dhjetor, në mos gaboj. Po, isha pjesë e konsultimit. Në fakt, është bërë për disa fshatra. Në diskutim, në kohën kur është bërë ky konsultim, kemi kërkuar për t'u marrë me procedurën e dokumentacionit përkatës, pajisjen me certifikatë pronësie. Ka pasur ndonjë problem. Qytetarët kanë ardhur për të sjellë. Nëse ka dokumentacionin, thamë që do lëmë edhe afatin e duhur.

Z. Torra: Ishin dy momente. Momenti i parë është ku ne kemi lënë kohë për të sjellë atë dokumentacion, edhe momenti i dytë, në momentin që do bëhet procedura, të jetë një afat më i gjatë se afati që ishte, që banorët të kenë mundësi për të mbledhur këtë dokumentacion. Në fazën e parë ne mbaruam procedurat e regjistrimit. Nuk kemi pasur asnjë njeri të sillte dokumentacionin. Faza e dytë, në momentin që do kemi shprehjen e interesit, do vazhdojmë në bazë të procedurave.

Znj. Kryetare: Atëherë, ka pyetje?

Z. Gjona: Duke qenë se ka të bëjë me Njësinë Administrative, desha të bëj një pyetje: a ka pasur ndonjë banor nga fshati Tushemisht në konsultim?

Znj. Topa: Po, ka pasur. Ka marrë pjesë Kryeplaku edhe banorë të tjerë. Në fakt, kur bëhen konsultimet afër qytetit, përgjithësisht kemi pjesëmarrje.

Znj. Kryetare: Jemi të qartë. Vazhdojmë, e hedhim në votim. Kush është dakord?

U votua

Pro 16

Kundër 1 (K.Gjona)

Abstenim 4 (F.Pikuli , A. Beka , E.Mancellari, M. Biba)

Miratohet Po Jo



7. Për përjashtimin e përkohshëm nga tarifat vendore për subjektet që ushtrojnë aktivitet në zonën historike A, për ti dhënë mundësi zhvillimi kësaj zone.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e radhës. Nga komisionet, do të flasë ndokush? Sipas rregullores, së pari flasin këshilltarët që kanë marrë pjesë në komisione. Nga mbledhja tjetër nuk do kalohet asnjë projekt -vendim pa u shprehur komisionet. Ju lutem, kolegë këshilltarë, të merrni pjesë në komisione. Kemi edhe kryetar komisioni, edhe zëvendëskryetar dhe sekretar. Komisionet janë shumë të rëndësishme. Është kryetari I komisionit ai që thërret mbledhjen e komisionit dhe pastaj njoftohen. Sekretarja e këshillit ka detyrimin vetëm të njoftojë. Përgjegjësinë e mbani ju, përgjegjësia është e gjithsecilit prej nesh. Faleminderit.

Znj. Enjela: Jemi në përfundim të projektit të rrugës “Naim Frashëri” deri tek Topleci. Duke qenë se kjo është një zonë historike dhe shumë e bukur për qytetin, duke parë kushtet aktuale, tek rruga “Naim Frashëri” rezultojnë 4 biznese, ku dy janë mbyllur për shkak të rrugës dhe dy funksionojnë. Janë pak aktivitete dhe ne duam që këto dy zona, si Bashki, t’i zhvillojmë. Kemi menduar që t’i ndihmojmë bizneset e vogla 0–2 milion. mendojmë që për dy vitet e para t’i lehtësojmë nga tarifat, vetëm këto dy zona. Unë mund të them që në zonën e Toplecit është vetëm një bar-kafe dhe disa ushqimore, përveç profesioneve të lira që nuk do të përjashtohen dhe vetë kompanitë e ndërtimit.

Z. Pikuli: A i keni përcaktuar? Vendorsni një listë.

Znj. Enjela: Po, janë të përcaktuar.

Znj. Biba: Po flasim me emra.

Znj. Enjela: Ato janë biznese të reja, përveç bizneseve aktuale që janë. Ne po flasim për t’u dhënë një dorë bizneseve të reja, sepse me gjithë këtë vështirësi që po hasin, ata e kanë vazhduar aktivitetin.

Z. Mancellari: Kjo që po hiqet është pjesa e tarifave? Do jenë thjesht ambiente?

Znj. Enjela: Çfarëdo që të jenë, ku janë 0 deri në 2 milion, të gjithë do përfitojnë, përveç profesioneve të lira, për dy vjet, deri në 2028.

Z. Mancellari: Po flas për një biznes që përfaqëson kulturën e vjetër të prodhimit dhe dëshiroj që edhe ky biznes të përfshihet në uljen e taksave.

Znj. Enjela: Po, patjetër. Nëse ai ka deklaruar xhiron më të lartë se 0–2 milion, nuk përfiton. Ne mendojmë të ndihmojmë këto kategori biznesesh.

Z. Mancellari: Po nëse ai e ka tejkaluar, nuk ka mundësi?

Znj. Enjela: Nëse ai e ka tejkeluar, do të thotë që ai e përballon. Ne mendojmë gjithmonë për ta ndihmuar atë zonë.

Z. Mancellari: Po nuk mund të përgjysmohet?

Znj. Enjela: Do na ndodhë që shumë biznese do ndryshojnë adresë për të ulur tarifat. Më mirë jemi tek kjo kategori që ne kemi zgjedhur. Po kaluan vlerën mbi 2 milion, subjektet nuk e kanë problem.

Znj. Kryetare: Ju faleminderit. Të flasim në përgjithësi, mos merremi me detaje. E hedhim në votim. Kush është dakord për lehtësimin e bizneseve?

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



8. “ Miratimin e tavaneve Përgatitore të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2027 – 2029 të Bashkisë Pogradec “

Znj. Kryetare, vazhdojmë me rendin e ditës. Vazhdojmë me diskutimet nga komisionet. Po, z. Haxhillari, ju lutem.

Z. Haxhillari: Ky projekt-vendim ka lidhje me një praktikë të zakonshme që bëhet për projekt-buxhetin afatmesëm 2029. Është në fazën e një rutine të përditshme deri sa të arrijë në fazën përfundimtare. Nuk ka kundërshtime nga ato që ne kemi trajtuar në periudhën e mëparshme. Është e njëjta procedurë. Ju faleminderit.

Znj. Kryetare: Kolegët e tjerë, ndonjë pyetje? Nëse jo, vazhdojmë. Ju lutem, e hedhim në votim.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



9. Për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Pogradec.
Znj. Kryetare:

Vazhdojmë me projekt vendimin e radhës. A dëshiron të flasë dikush nga komisionet?

Znj. Cina: Programi i transparencës është një detyrim ligjor që miratohet çdo 4 vjet. Ne e kemi miratuar në vitin 2024, por për arsye se Komisioneri ka nxjerrë një urdhër të ri për miratimin e programit model të transparencës dhe urdhri nr. 2011 është shfuqizuar, kemi vendosur që të miratojmë përsëri programin e transparencës.

Brenda këtij programi janë shtuar edhe kompetencat e Këshillit Bashkiak. Ju faleminderit!

Znj. Kryetare: Komisioneri ka qenë gjithashtu i pranishëm në mbledhje. Ky veprim është bërë në bazë të urdhrit të nxjerrë prej tij. Jemi dakord.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



10. Për procedurën e realizimit të shpronësimit të pasurive që preken nga realizimi I projektit të sistemit të rrugës të bllokut, “ Përroi I Caprazit” , për interes publik ” .

Znj. Kryetare, vazhdojmë me projekt-vendimin e radhës. Ky është një projekt-vendim që e kemi pasur edhe herën e kaluar. Është zhvilluar edhe konsultimi publik dhe kemi pasur pjesëmarrjen e banorëve. Kush ka dëshirë të flasë nga kolegët? Kanë marrë pjesë banorët që kishin interes.

Znj. Beka: Ishin banorët që prekeshin nga shpronësimi. Bëhet fjalë për rrugën që të mund të kalojnë banorët.

Znj. Kryetare: Kemi pyetje? Pronarët janë dakord, e hedhim në votim. Ju lutem.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



11. Për dhënie e ndihmës financiare për Z. Hysni Mahmutllari, familje që ka pasur dëme në orendi / paisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjes.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me rendin e ditës. Ju lutem, shikoj që të gjitha rastet kanë të njëjtin qëllim, apo jo?

Z. Torra: Janë përmbytjet e dyta.

Znj. Kryetare: Do lexojmë vetëm emrat dhe do hidhen një nga një në votim. Mund të jepni një shpjegim për të gjitha rastet në mënyrë parimore, si edhe parimin se si vlerësohen? Shpresoj që dokumentacioni është i rregullt.

Z. Torra: Procedura është që pranohet kërkesa dhe brenda pesë ditëve shkon komisioni i konstatimit, ku bëhen foto dhe mbahet procesverbal. Dokumentacioni sillet pranë zyrës ku është komisioni i vlerësimit, i cili nxjerr vlerën. Ne kemi një limit të vlerës, minimum dhe maksimum, duke përcaktuar vlerën e çdo orendie dhe pajisjeje, ndërsa dëmet e tjera përcaktohen ndryshe. Për dëmet në orendi, ne sjellim shumën 100%, ndërsa për dëmet në objekt paguhet 50%. Ju faleminderit.

Znj. Kryetare: Jemi të qartë. Vazhdojmë. Kush është dakord?

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

12. Për dhënien e ndihmës financiare për z. Klajdi Afesllari, familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje si pasojë e përmbytjes.

Znj.Kryetare: Vazhdojmë me të njëjtin shpjegim, kush është dakort ?

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

13. Për dhënien e ndihmës financiare për z. Haskeri Dervishllari, familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje si pasojë e përmytjes.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

14. “ Për dhënien e ndihmës financiare për znj. Leontina Tasellari , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 21

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

15. “ Për dhënien e ndihmës financiare për z. Pirro Prifti , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”

Znj.Kryetare: Ehedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

16. “ Për dhënien e ndihmës financiare për z. Fari Laraku , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

17. “ Për dhënie e ndihmës financiare për znj.Violeta Piqoni , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmytjes.”

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

18. “ Për dhënien e ndihmës financiare për z. Sokol Elmasllari , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmytjes.”

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

19. “ Për dhënien e ndihmës financiare për z. Ferit Afezi , familje që ka pësuar dëme në orendi/ paisje elektroshtëpiake dhe të anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes.”

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

20. Për dhënie e ndihmës financiare për z. Nihat Afesllari, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmytjes.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

21. Për dhënie e ndihmës financiare për z. Eqerem Yzellari, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

22. Për dhënien e ndihmës financiare për z. Bujar Fezollari, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

23. Për dhënien e ndihmës financiare për z. Luan Kuqo, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.


U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

24. Për dhënien e ndihmës financiare për z. Lazaron Naco, familje që ka pësuar dëme si pasojë e përmbytjes.

Znj.Kryetare: E hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



25. "Miratimin e cmimit maksimal ditor për shfrytëzimin e setit cadër plazhi+ 2 shezlog, në plazhin e Bashkisë Pogradec nga subjektet private që ushtrojnë veprimtari si stacione plazhi".

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikat shtesë. Është një projekt-vendim që na ka ardhur më përpara dhe është kryer konsultimi publik. Kush dëshiron të flasë nga kolegët që ishin prezent në komisione?

Znj. Beka: Në konsultimin publik që u zhvillua nga ana e bizneseve u dha një propozim që çmimi të jetë 1000 lek për set. Kuptohet, si çmim tavan, ky çmim u vendos nga kërkesat e bizneseve.

Znj. Topa: Përshëndetje. Në fakt, unë nuk isha pjesë e konsultimit publik. Kam parë një diferencë në 1000 lek të reja. Për sa kohë është në interes të bizneseve, unë mendoj që Pogradeci vetëm fundjavat ka lëvizje. Mendoj që gjatë javës, një sugjerim nga ana ime për biznesin është të rishikojnë çmimin e çadrave, sepse nuk njihemi si një vend i shtrenjtë.

Znj. Enjela: Bizneset e ngritën këtë problem për të punuar me dy çmime. Vendosën që për të gjithë qershorin dhe 15 ditëshin e parë të korrikut të japin një çmim më të ulët. Pastaj kjo është pjesë e menaxhimit të tyre.

Znj. Topa: Në teori jam dakord. Shpresoj të mos mbajnë vetëm çmimin tavan. Për sa kohë kemi rritje këtu, duhet të aksesojnë edhe qytetarët. Unë nuk jam kundër rritjes së çmimit, por e rëndësishme është që të rritet standardi.

Znj. Enjela: Bashkia hyri me çmimin 700 lek të reja, ndërsa sygjërimi nga bizneset ishte 1000 lek të reja.

Z. Xhyra: Mos duhet të ishin pjesë e konsultimit publik edhe qytetarët?

Znj. Enjela: Konsultimi publik nuk bëhet në këtë rast për qytetarët, por për bizneset. Bashkia ka vendosur plazhin publik ku çdokush mund të shkojë. Çmimi tavan është vendosur që bizneset të mos abuzojnë, ashtu si edhe në bashkitë e tjera.

Z. Xhyra: Rritja e çmimit prek qytetarët në përgjithësi, por të rritet nga 500 në 1000 është shumë.



Znj. Enjela: Vitet e kaluara nuk ka pasur fare çmim tavan, çmimet vendoseshin nga subjekti sipas dëshirës. Këtë vit janë nga 0 deri në 1000. Dikush që do cilësi të lartë do të shkojë atje ku e gjen këtë cilësi. Për subjektet ka shpenzime, kanë vrojtues plazhi dhe të gjitha janë me vrojtues. Unë jam pjesë e menaxhimit të tyre dhe kanë shpenzime.

Znj. Kryetare: Ju lutem mbani qetësi.

Z. Babasuli: Ju lutem, mund të shpjegoj diçka? Kjo është thjesht një vendosje e çmimit tavan. Kryesisht ka ardhur si rrjedhojë e propozimeve dhe çmimeve të bregdetit. Ne nuk kemi abuzime me çmimet. Çmimi maksimal është 1000 lek të reja dhe ne si bashki e propozuam 700 lek të reja, bazuar në logjikën që ju përmendët në konsultimet publike dhe për të rritur disi cilësinë.

Po shtohet në 1000 lek, por ato mund të vazhdojnë të jenë edhe 200 lek të reja, ashtu siç kanë qenë. Ne, me këtë projektvendim, përcaktojmë vetëm tavanet. Thjesht është për të ulur abuzimet me çmimet e shezlloneve.

Z. Xhyra: Ju thërrisni biznesin në konsultim, jo qytetarët.

Znj. Enjela: Po, për biznesin bëhet fjalë, sepse qytetarët kanë plazhe publike ku mund të shkojnë.

Z. Babasuli: Nuk ka lidhje me qytetarët.

Znj. Kryetare: Njoftimi për konsultimin publik është bërë për të gjithë, ka qenë i hapur, nuk ka qenë një target grup.

Z. Mancellari: Nga përvoja personale në bregdet, kur prenotohet hoteli, ka edhe shezllonet në çmim, por ka edhe çmime të larta për ata njerëz që i preferojnë. Kurse për qytetin tonë është pak i lartë. Unë them të gjejmë një rrugë të mesme: 700 bashkia, 1000 bizneset, ne ta vendosim 800, sepse në fundjavë të gjithë do abuzojnë.

Znj. Enjela: 1000 e kanë pasur subjektet. Ne, në vend që ta rrisim, e ulim. Të ofrojnë bizneset më tepër cilësi. Të gjitha janë rritur, kurse ne si qytet t'u themi bizneseve uleni, mos e rrisni. Pogradeci ka plazhin publik, ku në asnjë vend nuk respektohet si këtu.

Znj. Kryetare: Ju lutem mbani radhën.

Z. Rama: Jam shumë dakord t'i jepet edhe një krah biznesit, por duhet të marrim parasysh më shumë qytetarët. Unë kam shumë miq dhe e zgjedhin Pogradecin si destinacion për fundjavën dhe një ndër arsyet që vijnë janë çmimet e favorshme. Në rast se ne vazhdojmë me sugjerimin e 6 ose 7 bizneseve...



Znj. Enjela: Po për ditët e javës, që bizneset i kanë bosh, mendon ndokush për to?

Znj. Kryetare: Fjalën e merr Z. Shyti.

Z. Shyti: Nuk mund t'u caktojmë bizneseve çmimin. Mund t'u lësh afat dhe të shikosh se sa investon biznesi. Kush ka mundësinë të zgjedhë, le të zgjedhë. Nuk mund të vendosësh tavan; kontrolloje tek pjesa e cilësisë dhe tatoje për atë çmim që ai mban. Pse mos e ngremë edhe në Pogradec atë që ai paguan në Jug dhe mos ta paguajë në qytetin tonë? Për mua personalisht, tavani të hiqet.

Znj. Enjela: Ne menduam të kemi tavan për të gjitha zonat. E theksoj edhe njëherë, kjo është bërë më tepër për bregdetin, jo për ne. Konkurrencën e bën plazhi publik. Kjo VKM jepte mundësinë edhe për vendosjen nga bashkia të një tarife, por ne nuk e pranuan.

Z. Shyti: Kontrolloni edhe çadrat e bashkisë, se keni abuzime.

Znj. Kryetare: Ju lutem, faleminderit. E hedhim në votim. Kush është dakord?

U votua

Pro 16

Kundër 1

Abstenim 5 (M.Rama, A.Prifti, S.Olldashi, E.Mancellari

Miratohet Po Jo



26. Për krijimin e tregjeve publike për tregëtimin e produkteve të ndryshme, në njësitë administrative Trebinjë dhe Proptisht.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me projekt vendimin e radhës. Sigurisht është një projektvendim në favor të banorëve. Ju lutem, do flasë dikush? Po, zonjushë Topa, ju lutem qetësi.

Znj. Topa: Nuk kam qenë pjesë e këtij komisioni. Sot kam marrë materialin. Mirë do të ishte të kishim ndonjë informacion, sepse nuk ka asnjë dokument. Kam frikë se ndoshta është një projektvendim që duhet konsultuar. Për sa kohë ju dëshironi të ngrini tregje në këto zona që keni çituar, minimumi duhet një informacion më i detajuar.

Z. Babasuli: Sot ne po japim hartën se ku do bëhen.

Z. Xhyra: Nuk ka nevojë për konsultim publik këtu. Bashkia ka marrë një nismë që është në favor të zonës dhe pa pagesë.

Znj. Topa: Kemi thënë që relacionet që shkojnë në Prefekturë na kthehen. Personalisht, për këtë projektvendim jam totalisht e paqartë.

Z. Babasuli: Me këtë projektvendim, me rrugët e reja që po bëhen, për të mos pasur problem me daljen e fermerëve nëpër rrugë dhe që të mos kemi aksidente, si dhe për t'i kontrolluar më mirë, kjo është logjika. Nëse kemi probleme teknike për ta përmirësuar, patjetër jemi këtu.

Znj. Topa: Jemi në rregull, sepse kjo tregon që institucioni po merr masa.

Z. Kryetar: Përshëndetje. Ky është një projektvendim për interesat e banorëve. Janë të bëra nga kompanitë. Janë dy tregje: njëri është mbi Kalivaç dhe tjetri në Proptisht, thjesht për t'i ndihmuar këta njerëz. Tregu do të jetë pa qira, kjo është ideja.

Z. Haxhillari: Një ide shumë e mirë, sepse në këto zona po hapet një perspektivë e re.

Znj. Kryetare: Nëse keni nevojë për ndonjë sqarim.

Z. Mancellari: Nëse ka mundësi, përveç Kalivaçit dhe Proptishtit, më erdhi mirë që ajo zonë sadopak po zhvillohet, por nëse ka mundësi edhe për zonën e Osnatit, që janë më afër Zdervaskës, të bëhet edhe aty një pikë.

Znj. Zhaneta: Të falënderojmë bashkinë dhe pronarët e tjerë për këtë nismë në kohën e duhur. Ju faleminderit.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30. 03. 2026

Z. Kryetar: Për këtë ne jemi, kemi 5 vjet që po presim të bëhet rruga aty. Po planifikohet të bëjmë një shesh panoramik.

Z. Gjona: Projektvendimi erdhi në mbledhjen e komisionit dhe unë isha pjesë e komisionit. Jam dakord me znj. Topa që relacioni është shumë i thatë. Na u tha që do të vijë i kompletuar, por është i njëjti siç ishte atë ditë.

Znj. Kryetare: Që të jemi të sqaruar të gjithë, qëllimi është që relacionet të jenë të plota dhe për të mos keqinterpretuar.

Znj. Kryetare: E hedhim në votim, ju lutem.


U votua

Pro 22

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Znj. Kryetare: Faleminderit. Jemi tek "Të tjera". Do ju lutesha të mos largoheni, kemi të drejtën të diskutojmë.

Znj. Prifti: Para disa muajsh kam bërë një propozim për titull nderi për zotin Xhemollari. Si ish I përndjekur politik, i përmbush kriteret; së dyti, për përfaqësimin që ka në shoqëri dhe së treti, si një shkrimtar. Është një njeri i nderuar. Unë i ftoj këshilltarët që të më mbështesin në këtë propozim. Mendoj që e plotëson totalisht për të marrë titullin "Qytetar Nderi".

Znj. Kryetare: Ju lutem, më lejoni të flas që të mos keqinterpretohem. Gjithmonë ka ardhur dokumentacioni i plotë. Nuk është Kryetari i Bashkisë që jep këtë titull nderi. Së pari shqyrtohet në Komisionin e Titujve të Nderit, ku verifikohet nëse janë plotësuar të gjitha kriteret dhe dokumentacioni i plotë. Më pas vjen në Këshill dhe, pasi vjen në Këshill, jemi ne si këshill që votojmë.

Znj. Prifti: Janë dërguar të gjitha dokumentet, është në rregull.

Znj. Kryetare: Mund ta ndjekim për të parë deri ku ka ngecur.

Z. Xhyra: Marr shkas për të diskutuar për afatin e shtyrjes nëpër shkolla për ngrohjen. Ne jemi një vend i ftohtë dhe afati është i shkurtër.


Z. Kryetar: Ne jemi munduar që shkollat të mos kenë mungesa. Sa herë që ata kërkojnë, ne i plotësojmë.

Znj. Biba: Ne si këshilltarë ndihemi borxhlinj dhe shkollat janë shumë të ftohta realisht. Nuk mund të fillojë në 15 nëntor dhe të mbarojë në 15 mars. Kemi rënë në dakordësi që të ndizet edhe kur është ftohtë dhe realisht është shumë ftohtë.

Z. Kryetar: E kanë për detyrë t'jua dërgojnë.

Znj. Kryetare: Ne kemi sugjeruar dhe diskutuar të biem dakord me administratën, sepse ka efekt financiar.

Z. Kryetar: Ne po presim fillimin e projektit të Lungo Gjolë në qershor dhe kjo është diçka për zhvillimin tonë si qytet. Desha të diskutoj edhe për pedanat. Si mendoni ju? Ka edhe nga ata



që duan t'i vendosin dhe nga ata që nuk duan. Ato nuk lejohen me ligj në pronën shtetërore, por meqë janë provizore, si mendoni, duhen apo nuk duhen?

Z. Shyti: Realisht, ato janë për tre muaj dhe duhen. Pogradecit i japin një bukuri më vete.

Z. Pikuli: Shfrytëzoj rastin që është kryetari: si mund të ndihmojmë artistët vendas? A kemi ndonjë mundësi për artistët pogradecarë, grupin "Nostalgjia"?

Z. Kryetar: Nuk është drejtori. Unë e kam diskutuar këtë temë dhe më kanë konfirmuar që grupi "Nostalgjia" ka qenë pjesë e aktiviteteve.

Z. Pikuli: Kanë qenë prezent, por jo aq shumë. Të promovojnë traditën pogradecare, kjo është kërkesa ime.

Z. Kryetar: Dakord. Drejtori i kulturës ma kundërshtoi, më tha që ky grup ka marrë pjesë. Megjithatë, ne do ta diskutojmë.

Z. Pikuli: Mekanizmin ta gjejë Qendra Multifunksionale, por të kenë parasysh t'i aktivizojnë më shumë.

Z. Kryetar: Kemi shumë projekte që janë gati. Një ndër këto është edhe Pallati i Kulturës.

Z. Shyti: Meqë u prek çështja e pedanave, për mua është diçka pozitive dhe duhet të vazhdojë trendi i pedanave, për arsye se bizneset mezi i presin këto muaj turizmi. Nuk është se preket diçka apo cenohet dikush. Është diçka pozitive edhe për qytetin tonë.

Z. Kryetar: Në momentin që ne po flasim, nuk na ka ardhur diçka akoma. Unë mendoj që duhen të jenë, sepse i kanë dhënë gjallëri qytetit.

Z. Kryetar: Drejtor, meqë erdhët, kemi një kërkesë për grupin "Nostalgjia". Do na bëni një projekt?

Z. Latifllari: Ne kemi diskutuar bashkë, kemi bërë aktivitete dhe ata kanë qenë pjesëmarrës.

Z. Kryetar: Kërkojmë më shumë angazhim. Mendoj të riorganizojmë grupin, të merren me veshjet dhe të kenë një ambient ku të kenë mundësi të bëjnë provat.

Z. Shyti: Tre muajt e verës.

Z. Kryetar: Në verë mund të aktivizohen më shumë. Këtë vit çdo fundjavë do bëhen aktivitete nga ne.



Znj. Kryetare: Kemi një kërkesë që na vjen vazhdimisht në lidhje me një pjesë tek lagjja Kala, ku ka mbetur një segment rrugor i pashtuar, që krijon vështirësi për banorët.

Sekretarja: Lexon kërkesat dhe ankesat.

Znj. Beka: Një informacion për paketën e maleve për zonën e Pogradecit. Nuk ishte përfshirë në fazën e parë zonat e përzgjedhura.

Z. Torra: Në lidhje me paketën e maleve, ne jemi në fazën ku kërkuan hartat. I dërguam në fazën e parë, ato u kthyen për vendimin dhe saktësimin e hartave. I konfirmuan, i sollëm përsëri dhe javën e parë i kaluam paraprakisht. Në zonën e Pogradecit janë 14 zona. Në momentin që do vijë vendimi, do ju japim edhe informacionin përkatës. Çdo qytetar i interesuar do bashkëngjisë edhe një ide për çfarë do ta zhvillojë.

Z. Kryetar: Vetëm një konstatim: nuk mund të interesohet çdokush. Do bëhet çdo gjë transparente. Hartat e miratuara tani do i sjellin. Të vendoset në dispozicion dikush nga ne për të sqaruar qytetarët.

Znj. Kryetare: Si kryetare e këshillit dhe në bazë të rregullores, kërkoj në bazë të nenit 24 të rishikohet kjo ankesë dhe kërkoj nga Komisioni i Mandateve që secili komision të mblidhet veç e veç dhe të fillojnë të bëjnë shqyrtimin e çështjes.

Znj. Topa: Ka anëtarë të ndryshëm që nuk janë juristë në profesion dhe barra do më mbetet mua. Kjo është një çështje me të cilën unë jam marrë shumë gjatë. Meqë ju po i lini kohë komisioneve, në fund të gjithë kësaj procedure mendoj të bëhet me procesverbal.

Znj. Kryetare: Ky komision dua të dalë me procesverbal dhe të shqyrtohen me imtësi.

Znj. Topa: Jo se dua të dal në mbrojtje të sekretares së këshillit, por ndoshta nuk i dini detyrat e saj. Ajo ka për detyrë të njoftojë këshillin për mbledhjen dhe mban dokumentet.

Znj. Zhaneta: Unë kam shkresën.

Znj. Kryetare: Nuk është nga znj. Entela, është nga Komisioni i Titujve të Nderit. Kemi shumë keqinterpretime këtu.

Znj. Kryetare: E deklaroj mbledhjen e mbyllur. Ju faleminderit.